

VENDIM
Nr.289, datë 28.4.2010

**PËR SHPALLJEN “PARK KOMBËTAR” TË EKOSISTEMIT NATYROR DETAR
PRANË GADISHULLIT TË KARABURUNIT DHE ISHULLIT TË SAZANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 1 shkronja “b”, 6 e 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror detar, pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit “Park Kombëtar”, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e përgjithshme e “Parkut Kombëtar” Karaburun-Sazan është 12 570.82 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e dy) ha, ndarë si më poshtë vijon:

2.1 Pjesa detare pranë gadishullit të Karaburunit ka sipërfaqe 9 848.95 (nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) ha, me kufijtë e mëposhtëm:

a) Veri: Pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L, deri te pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71 L;

b) Lindje: Pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71 L dhe më pas vijon përgjatë vijës bregdetare nga kepi i Shën Vasilit, kepi i Dhim Kushtës, kepi dhe gjiri i Shën Janit, kepi i Gjuhëzës, ndjek vijën bregdetare perëndimore të malit të Karaburunit, bregun e Gjinarës, faqen e Bishtit të Malit, Rrëzën e Kanalit, faqen e Langadhës deri te pika 3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L.

c) Jug: Pika 3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L, deri te pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L.

ç) Perëndim: Pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L dhe ndjek izobatin deri te pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L.

2.2 Pjesa detare pranë ishullit të Sazanit ka sipërfaqe 2 721.87 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) ha, me kufijtë e mëposhtëm:

Pika 1, me koordinata 4354004.14 V e 4487718.40 L;

Pika 2, me koordinata 4355536.33 V e 4486707.03 L;

Pika 3, me koordinata 4351587.21 V e 4485140.06 L;

Pika 4, me koordinata 4357134.42 V e 4486668.09 L;

Pika 5, me koordinata 4355142.57 V e 4486658.75 L.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Mbrojtjes (Rojë Bregdetare) dhe institucionet kërkimore-shkencore, merr masa për të siguruar ruajtjen, monitorimin dhe zhvillimin e ekoturizmit nënujor, në “Parkun Kombëtar” Karaburun-Sazan.

4. Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur Llogara-Karaburun kryen dhe funksionet e administratës së “Parkut Kombëtar” Karaburun-Sazan. Administrata e zonës së mbrojtur në ushtrimin e funksioneve bashkëpunon me strukturat përkatëse për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar dhe të ligjit “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike”.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe sipas përkatësisë, ministrinë e linjës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

